REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine
-XII- Nr. Prot. 247 Më 09.10 26
RAHOVEC - ORAHOVAC



# RAPORTI NËNTËMUJOR I PUNËS

## JANAR-SHTATOR 2026

## DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Tetor 2026

# 1. HYRJE

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në funksion të realizimit të politikave komunale në fushën e urbanizmit, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit. Veprimtaria e Drejtorisë zhvillohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, si dhe Statutit të Komunës Nr. 1005, të datës 29.03.2017, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Ky raport paraqet aktivitetet, angazhimet, rezultatet e punës dhe të hyrat e realizuara nga Drejtoria gjatë periudhës janar–shtator 2026.

Në kuadër të Drejtorisë funksionojnë dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit;
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit.

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria është angazhuar në trajtimin e kërkesave të qytetarëve, bizneseve dhe subjekteve të tjera, në ofrimin e shërbimeve administrative dhe profesionale, në zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, si dhe në realizimin dhe përcjelljen e projekteve zhvillimore në territorin e Komunës së Rahovecit.

Në kuadër të aktiviteteve të planifikimit hapësinor, gjatë kësaj periudhe është zhvilluar procesi i diskutimit publik për **Draft-Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit**, me ç'rast janë mbajtur gjithsej **nëntë (9) prezantime publike** të draft-dokumentit. Këto aktivitete kanë pasur për qëllim prezantimin e përmbajtjes së dokumentit, informimin e qytetarëve dhe palëve të interesuara, si dhe mundësimin e pjesëmarrjes së tyre në procesin e diskutimit dhe shqyrtimit të këtij dokumenti të rëndësishëm të planifikimit hapësinor.

## SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Gjatë periudhës raportuese, zyrtarët e Sektorit të Urbanizmit dhe Planifikimit kanë qenë të angazhuar në trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe investitorëve, si dhe në zhvillimin e procedurave administrative lidhur me pajisjen me kushte ndërtimore, leje ndërtimore, leje përdorimi, leje rrënimi, vërtetime urbanistike, legalizimin e ndërtimeve dhe çështje të tjera që ndërlidhen me fushëveprimin e sektorit.

**Kërkesat janë shqyrtuar në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi dhe brenda afateve të përcaktuara me legjislacionin përkatës.**

Për periudhën janar–shtator 2026, kërkesat e shqyrtuara janë:

| Janar- Shtator- 2026 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kërkesat** | **Nr.total** | **Aprovuar** | **Refuzuar** | **Në shqyrtim** | **Hudhet** |
| **Leje ndërtimi** | 49 | 37 | 0 | 12 | **0** |
| **Leje përdorimi** | 4 | 4 | 0 | 0 | **0** |
| **Leje rrënimi** | 12 | 9 | 0 | 3 | **0** |
| **Kushte ndërimore** | 87 | 67 | 9 | 5 | **6** |
| **Kërkesë /Shkresë** | 69 | 41 | 4 | 24 | **0** |
| **Vërtetim Urbanistik** | 20 | 11 | 3 | 5 | **1** |
| **Legalizim i objekteve** | 13 | 10 | 0 | 3 | **0** |
| **Gjithësej** | **254** | **179** | **16** | **52** | **7** |

Për periudhën janar–shtator 2026, të hyrat e evidentuara janë:

| | |
|---|---|
| **Parallogaria** | 90463.71€ |
| **Vertetim –Pelqim** | 1305€ |
| **Legalizim** | 5420.58€ |
| **Totali i të hyrave** | **97189.29€** |

## SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Në kuadër të Sektorit të Mbrojtjes së Mjedisit zhvillohen procedurat në fushën e mbrojtjes së mjedisit, përfshirë shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve mjedisore komunale dhe lejeve ujore komunale, në përputhje me kompetencat komunale dhe legjislacionin në fuqi.

## KËRKESAT E SHQYRTUARA

| Lloji i kërkesës | Nr. total | Aprovuar | Refuzuar | Në shqyrtim | Hedhur |
|---|---|---|---|---|---|
| Leje mjedisore | 25 | 22 | 3 | 0 | 0 |
| Gjithsej | 25 | 22 | 3 | 0 | 0 |

Të hyrat e realizuara nga Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit për periudhën raportuese janë 5,689.52 €.

## HARTIMI I HARTËS ZONALE 2026–2034

Gjatë periudhës raportuese, kanë vazhduar aktivitetet për hartimin e Hartës Zonale të Komunës për periudhën 2026–2034. Drafti i dokumentit i është nënshtruar shqyrtimit publik nga data 16 korrik deri më 16 gusht 2026. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar komente dhe rekomandime nga palët e interesuara, të cilat do të shqyrtohen dhe trajtohen në fazën e finalizimit të dokumentit.

## NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT

Ndërtimi i Sheshit Qendror është një nga projektet kryesore të zhvillimit urban të Komunës.

Punimet në terren kanë vazhduar, megjithëse me intensitet më të ulët për shkak të situatës së krijuar nga procedurat përmbarimore.

## NDËRTIMI I KULLËS NË RETIJË

Ka vazhduar veshja e objektit me gurë, ndërsa punimet e brendshme janë përfunduar për shkak të situatës së krijuar nga procedurat përmbarimore punimet do të ndalen.

**Albror Mullabazi**

**Drejtor i DUPMM**